



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

MINISTRI

Nr. 9823 Prot.

Tiranë, më 02.10.2017

UDHËZIM

Nr. 21, datë 02.10.2017

**PËR
DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 15, DATË 19.05.2017 “PËR PROCEDURAT E
PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË VITIN AKADEMIK 2017-2018”, I
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 9 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Pika 2 e gjermës “C” të Kreut III të Udhëzimit nr.15, datë 19.05.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:
*“2. Periudha 1 tetor deri 14 tetor është e ndarë në 7 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në njërin apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.
Kur ai është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48 orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë. Për programet e studimit të ofruara nga universitetet private të cilat nuk parashikojnë kritere shtesë, nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe.
Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 7 fazave 48-orëshe MASR dhe QSHA do të publikojnë një Udhëzues Teknik në faqet përkatëse zyrtare www.arsimi.gov.al dhe www.qsha.gov.al.*
2. Pika 4 e Gjermës “C”, të Kreut III të Udhëzimit nr.15, datë 19.05.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:
“4. Në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj mund të regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Këto faza vijojnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën 14 tetor 2017. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara të cilat nuk ka aplikantë në pritje, do të rikthehen në garë aplikantët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të

regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi në garë kryhet sipas listës së renditjes të aplikantëve për raundin e dytë.

3. Pika 14, e kreut VI/1 të Udhëzimit nr.15, datë 19.05.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:
“14. Regjistrimi i kandidatit, i cili paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij kryhet pranë sekretarive mësimore nga data 10 tetor 2017 deri më datë 14 tetor 2017 sipas dokumentacionit të dorëzuar në momentin e aplikimit. Kuotat e paplotësuara plotësohen me kandidatët e renditur sipas pikëve të fituara mbas vijës së kuqe, brenda datës 24 tetor 2017.”.
4. Pika 15, e kreut VI/1 të Udhëzimit nr. 15, datë 19.05.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:
“15. IAL-të brenda datës 27 tetor 2017 dërgojnë në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin e tyre.”.
5. Pika 1, e kreut VI/3 të Udhëzimit nr. 15, datë 19.05.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:
“1. Të gjithë kandidatët shtetas të huaj që dëshirojnë të ndjekin studimet në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018, aplikojnë pranë institucioneve të arsimit të lartë (IAL), nga data 16-19 Gusht 2017, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL.”.
6. Germa “b” e pikës 14 të kreut VI/3 të Udhëzimit nr. 15, datë 19.05.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:
“b. Njohja e dokumentacionit të kandidatëve fitues, të pajisur me diploma të huaja, në programet e përbashkëta të studimit, kryhet gjatë zhvillimit të semestrit të parë. Regjistrimi si student i kandidatëve fitues bëhet me rezervë, deri në përfundim të procedurës së njohjes së dokumentacionit shkollor të tyre. Pas përfundimit të njohjes, QSHA kryen regjistrimin e tyre përfundimtar me statusin e studentit dhe brenda datës 26 janar 2018 ja komunikon IAL-së”.
7. Germa “f” e pikës 14 të kreut VI/3 të Udhëzimit nr. 15, datë 19.05.2017, të ndryshuar, ndryshon si më poshtë:
“f. IAL-të brenda datës 27 tetor 2017 dërgojnë në Qendrën e Shërbimeve Arsimore listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi. Për të gjithë emrat e studentëve të dërguar pas kësaj date nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA të kërkojë nga IAL-ja çregjistrimin e tyre.”.
8. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, DAR/ZA-të si dhe Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

